



METODOLOGJIA E TË MËSUARIT TË KURANIT PËRMENDËSH

Prof.Dr. Hfz Hajredin Hoxha



Metodologjia e te Mesuarit te Kur'anit

Permendsh

(Keshilla te arta per fillestaret ne hifz)

Hfz.Hajredin Hoxha
E-mail:drhafezi68@gmail.com

Prizren 1995

BISMIL-LAHIR RAHMANIR RAHIM

Parathenie

Falenderimi i takon Allahut xh.sh. qe i shpalli Kur'anin Muhamedit a.s. qe te jete udhezues per tere boten. Nga Ai ndihme kerkojme, sepse Ai eshte qe e shpalli Kur'anin dhe Ai ua lehtesoi roberve mesimin e tij permendsh, me qellim qe te kuptojne ate dhe te lexojne ate ashtu sic e ka lexuar dhe kuptuar Muhamedi a.s.

(EI-Kamer, 17)

Muhamedi a.s. ne nje hadith thote:

“ Me i miri nga ju eshtei qe e meson Kur'anin dhe ate ua meson te tjerve ”

(Transmetim i Imam Buhariut).

VIRTYTET E TE MESUARIT TE KUR'ANIT PERMENDSH

Te mesuarit permendsh te Kur'anit-hifzi, konsiderohet nje nga ibadetet me te medha e me te vlefshme te Allahu xh.sh. Kete e verteton edhe hadithi i Muhamedit a.s. ku thote: "Hafizet e Kur'anit jane njerez te dalluar e te cmueshem te Allahu xh.sh." (Transmetim i Imam Nesaiut dhe Ibni Maxhes).

Ne ditën e gjykimit hafizi i Kur'anit gezon merite te larte te Allahu xh.sh. Muhamedi a.s. ne nje hadith thote: "Lexonie Kur'anin sa me shume sepse ne ditën e gjykimit leximi i Kur'anit u ben shefat lexuesve te tij".

Qellimi i te mesuarit permendsh te Kur'anit konsiston ne perseritjen e tij te vazhdueshme me qellim qe te mos harrohet, te edukimit tone, te realizimit te urdherave te Tij, te largimit nga ndalesat e Tij, te transmetimit brezave te rinj. Muhamedi a.s. ne nje hadith thote:” Ata te cilet e mesojne permendsh Kur'anin dhe ate e lexojne shpesh, ndersa nga ana tjeter nuk zbatojne dispozitat e Tij ne ditën e gjykimit se pari ata do te denohen me zjarr xhehnemi”. Mirepo, insha-Allah Allahu na ben qe te meritojme xhenetin e tij .

ZBATIMI I DISA METODAVE ME PRAKTIKE GJATE MESUARJES PERMENDSH TE KUR' ANIT

Fillimisht, per mesimin permendsh te Kur'anit lypset nje shkalle e larte sinqeriteti, sepse kjo behet me qellim te fitimit te kenaqesise se Allahut xh.sh.

Hafizi duhet te jete me abdest dhe pergjithesisht pastertia e tij duhet te jete ne nivel, sepse Allahu xh.sh. ne Kur'an thote: “ *Ate (Kur'anin) nuk e prek kush perpos te pasterve*”. (El Vakia, 79).

Nga ana tjeter eshte e pelqyeshme qe dhembet te pastrohen me misfak ose me brushe sepse goja e besimtarit eshte rruga e Kur'anit andaj ajo duhet te jete prore e paster si dhe mundesisht te parfumosemi.

Gjithashtu, duhet te ekzistojte deshira dhe vullneti i zjarrte per te realizuar kete synim te larte e te rendesishem me qellim qe te arrihet suksemi i plote.

Gjate leximit te Kur'anit preferohet te orientohemi kah Kibla si dhe te jemi te ulur mbi gjunj.

Duhet te kerkojme ndihme dhe mbeshtetje te Allahu xh.sh. prej shejtanit te mallkuar duke thene: "Eudhu bil-lahi mineshejtanir- raxhim", dhe lexuar "Bismil lahir –rahmanir-rrahim" nese eshte fillimi i Sures. Allahu xh.sh. ne Kur'an thote: "Dhe kur don te lexosh Kur'anin kerko ndihme dhe mbeshtetje tek Allahu xh.sh. prej shejtanit te mallkuar" (En-Nahl, 98).

Prandaj e shohim te udhes te theksojme disa metoda qe mund te aplikohen e qe jane te preferueshme lidhur me mesimin permendsh te Kur'anit te permbledhura me sa vijon:

1. Leximi i Kur'anit duhet te behet me texhvid me cka nenkupton ushtrim paraprak para prezences se hafizit ose te personit qe njeh rrjedhshem leximin e Kur'anit (hoxhes).

2. Suret -kaptinat Kur'anore perkatesisht ajetet duhet lexuar mire e pa gabime para hafezit e me pastaj kalojme ne leximin e sures perkatesisht ajeteve. Jane dy menyra per mesimin e sureve te planitikuara:

a) Leximi i tyre te perseritet nga disa here me Kur'an te hapur gjithnje derisa te mesohen permendsh. S'do mend se aplikimi i kesaj metode konsiderohet paksa i veshtire sepse kerkon sakritice e perkushtim te madh.

b) Mesimi i tyre te behet me ajete. Ajetin e pare e perserisim disa here gjithnje derisa te mesohet permendsh e pastaj kalojme ne ajetin vijues duke vepruar si me te parin. Serish ajetin vijues e lexojme e pastaj kthehemi duke e bere lidhjen e ajetit te pare me te dytin, gjithnje gjersa keto te mesohen permendsh e keshtu me radhe. Kjo metode e te lexuarit mbase mund te konsiderohet me e lehte nga e para, per shkak se lexuesit i duket se ka te beje me nje numer me te vogel ajetesh.

3. Metoda tjeter konsiston ne faktin qe hafizi duhet te kete ne disponim nje botim te vecante te Kur'anit, dedikuar per kete qellim, me c'rast faqja perfundon me mbarimin e ajetit. Ne gjuhen arabe ky botim i Kur'anit quhet MUS'HAFUL - HUFF ADH (Kur'an hafizesh). Tiparet e ketij botimi Kur'anor jane:

a) Te gjitha ajetet e nje faqeje kandidati i ka para veti pa u hutuar ne faqen tjeter fare.

b) Cdo faqe e ketij muls'hafi ka nga 15 rreshta si dhe cdo xhuz i ketij mus'hafi i ka nga 20 faqe, perjashto xhuzin e fludit "XHUZ'U-AMME" qe i ka 23 faqe.

Kemi botimin tjeter te Kur'anit, me c'rast faqja e tij nuk perfundon me mbarimin e ajetit. Nje pjese e ajetit perfundon edhe ne faqen tjeter. Lloji i ketille i botimit s'eshte edhe i preferuar per hifz. Verzioni i pare (MUS'HAFUL - HUFADH) eshte tejet praktik dhe me i afirmuari aktualisht qe aplikohet ne boten Islame ne institucione te hifzit, bie fjala ne Mekke, Medine, Damask, Xhide, Kajro, Istambul, etj. Do permendur se sot ne boten Arabe dendur aplikohet

Kur'ani per hifz i botuar ne Medine¹, ne shtypshkronjen e mbretit Fehd. Tiparet pozitive te ketij botimi te Kur'anit jane:

a) Eshte i kontrolluar nga ana e hafezllareve, kurrave, doktor profesoreve, specialisteve me eminente te botes arabe, te cilet jane anetare te komisionit botues, emrat e te cileve jane te shenuara ne fund te Kur'ant².

b) Eshte nje verzion tjeter i botimit te Kur'anit qe eshte i ndare ne gjashte pjese dhe secila pjese i ka nga pese xhuza te Kur'anit. Ky verzion i Kur'anit i gjason verzionit te pare, mirepo nje pjese e ketij i ka 100 faqe.

Kandidati per hifz per te realizuar suksesin dhe me qellim qe te jete i frytshem preferohet qe mundesishte te gjeje nje kolege te moshes se njejte ne menyre qe se bashku te prezentohen te hafizi i tyre. Eshte e rekomandueshme qe hafizat e rinj t'ia degjojne leximin e njeri-tjetrit para se ti paraqiten hafizit te tyre.

4. **Kandidati per hifz** i cili ka problem me mesimin permendsh te Kur'anit i rekomandohet nje metode shume efikase se si ate ta mesoje:

a) Po qe se e zoteron gjuhen arabe, atehere i preferohet te beje ndarjen e ajeteve ne tematika te caktuara dhe ato t'i mesoje.

b) Po qe se nuk e zoteron gjuhen arabe, per te preferohet te beje ndarjen e ajeteve sipas shqiptimeve te njejta te ajeteve, bie fjala:

"JA EJ JUHEL'LEDHINE AMENU"

Duke vazhduar se mesuari deri te ai vend tek perseritet i njejti ajet, ose ajeti tjeter:

"JA EJ JUHEN NAS"

¹ Ne vendin tone verzionit te pare te Kur'anit iu eshte vu emri Kur'an sajfali.

² Me modesti mund te deklaroj se gjate kohes se studimeve ne Medine ne fakultetin e Kur'anit dhe shkencave Islame, pjesa dermuese e ketyre personaliteteve ishin mesimdhesisit e mi. Gjithashtu, kam pasur nderin dhe fatin ta kryej me sukses specializimin e leximit te Kur'anit dhe te hafezllekut, sipas transmetimit Hafis nga Asimi dhe ne kete menyre te bashkangjitem zingjirit te hafezllareve, i cili zingjir saktesisht arrin gjer te Muhamedi a.s. Te gjitha keto u ceken me qellim qe te jene faktore nxitjeje kandidateve te rinj ne hifz dhe s'eshte i inspiruar nga motivacionet tjera.

Derisa te vie ai vend tek perseritet i njejt i ajet, ose ajeti tjetër:

" JA BENIJ ADEME"

Derisa te vie ai vend tek perseritet i njejt i ajet.

c) Mund te behet edhe ndarja e ajeteve sipas shkronjave qe lidhen, per shembull me shkronjen "V":

"KALE RABBISH RAHLI SADRI VE JESSIR LI EMRI VE UHLUL UKDETEN MIN LISANI"

Ose mesojme ajetet sipas mbarimit te shkronjave te njejt, per shembull, shkronja "D":

"KUL HUVELLAHU EHAD -ALLAHUS SAMED LEM JELID VE LEM JULED..."³, ose ajetet e kaptines **"MUHAMED"** qe mbarojne me shkronjen "M".

Rendesia e kesaj metode konsiston ne faktin se ne kete menyre hafizit te ri i pakesohet faqja e parapare per mesim. Mirepo, ne qofte se hafizi i ri ka treguar talent, faqen e parapare per te mesuar e meson teresisht ose gjysmen e saj si dhe nje ajet nga faqja pasuese.

5. Metoda e pllakave. Eshte kjo nje metode klasike, praktike dhe tejet e suksesshme per hifz. Menyra e aplikimit te kesaj metode konsiston ne faktin se ajetet e parapara per mesim te shkruhen ne nje pllake druri a llamarine, pllaka ne fjale i ipet kandidatit per hifz gjersa ai t'i mesoje ajetet e shkruara. Gjate procesit te mesimit te ajeteve te shenuara ne pllake kandidati gradualisht fillon t'i shlyeje ajetet vende-vende ne menyre qe te bindet ne suksesin e vet per leximin e tyre pa pllake⁴

³ Me sa jemi te informuar askund nuk ekziston verzioni i ndonje botimi Kur'anor ku ajetet jane te tematizuara, se kendejmi, preferohet qe hafizi i ri te bashkepuoje me nje hafiz me eksperience, ne menyre qe te pervetesoje metodologjine e tij te punes.

⁴ Eshte e udhes te permendet se gjate kohes se studimeve kemi pase kolege hafezllare vendesh te ndryshme te cilet e kane kryer hifzin me kete metode, madje ata kane qene nder me te dalluarit ne garat e organizuara per Kur'an.

6. **Hartimi i planprogramit te caktuar.** Per te arritur sukses ne procesin e mesimit per hifz, rekomandohet nje planprogram vjetor per kandidatin qe deshiron ta mesoje Kur'anin per nje vit nga dy faqe ne dite, si dhe te rezervoje nje dite ne jave per perseritje. Planprogrami ka kete permbajtje:

a) Muaji	Kaptina
Janar:	El-Fatiha dhe El-bekare
Shkurt:	(Ali Imran 1) -(En-Nisa, 77)
Mars:	(En-Nisa, 78) -(El En'am., 58)
Prill:	(El En'am, 59) -(El En'fal, 40)
Maj	(El En'fal, 41) -ne fund te kaptines (Hud)
Qershor:	(Jusuf) -ne fund te kaptines (En'Nahl)
Korrik:	(El'Isra) -(El'enbija)
Gusht:	(El'haxh) -(En'neml)
Shtator:	(El'kasas) -(Sebe'e)
Tetor:	(Fatir) - (Fussilet)
Nentor:	(Esh'shura) -(El'vakia)
Dhjetor:	(El'hadijd) -(En'nas).

b) Kemi nje program tjeter kohor kater muajsh.

Aplikimi i programit ne fjale konsiston ne faktin se brenda dites duhet te mesohen nga pese faqe, keshtu qe duke praktikuar kete program, kandidati per keta kater muaj fiton **titullin hafiz i Kur' anit.**

7. Kandidatit per hifz gjate procesit mesimor i rekomandohet te izolohehet nga te tjeret ne menyre qe te jete i disponuar dhe i koncentruar per pune.

8. Kandidatit per hifz i rekomandohet qe gjate mesimit te lexoje me nje ze mesatarisht te ngritur. Ne fakt, kjo metode ka qene e aplikuar edhe nga vete Muhamedi a.s. (Imam Buhariu, 6-107 dhe Imam Muslimi fq. 545).

9. Kandidatit per hifz eshte e rekomandueshme te konsumoje ushqim te lehte me permbajtje te pasur pa e ngarkuar shume organizm

10- Te planifikohet koha e pershtatshme per mesimin e Kur'anit. Koha me e pershtatshme per kete mesim eshte:

a) Pas namazit te sabahut, 2-3 ore

b) Pas namazit te icindise deri ne namaz te akshamit pasiqe pas namazit te drekes kemi pushuar nje kohe te mjaftuar prej 2 oresh

c) Pas namazit te akshamit deri ne namaz te jacise, sepse truri ndodhet ne gjendje ende te fresket.

11. Kandidati per hifz duhet te kete nje hafiz me pervojte i cili e lexon Kur'anin me texhvid, ne menyre qe kandidatit vazhdimisht t'ia kontrolloje hifzin, sepse eshte e pamundur qe kandidati ne menyre individuale ta persosi hifzin. Per te deshmuar rendesine e metodes ne fjale, do t'i referohemi rastit te Xhibrilit a.s. kur ia komunikonte Shpalljen - Kur'anin Muhamedit a.s. me c'rast Muhamedi a.s., me interesim e vemendje e percillte kete menyre te komunikimit. Muhamedi a.s. menyren e ketille te komunikimit ia transmetonte sahabeve te tij, ndersa sahabet ia transmetonin tabiineve dhe keta gjeneratave pasuese.

Po te mos transmetohej Kur'ani ne kete menyre nga ana e hafizeve te rinj ose te vjeter do te humbej autenciteti i te lexuarit dhe i te komentuarit te Kur'anit, (En'Neml, 6 dhe EI- Kijame,16-18).

Poashtu, lidhur me kete e kemi edhe hadithin e Muhamedit a.s. qe thote: "Ne mjeshterine e leximit te Kur'anit mbeshtetuni te keta shoket e mi: Abdullah Ibni Mes'udi, Salim Ibni Ma'kili, Muadh Ibni Xhebeli dhe Ubej Ibni Ka'bi" (Transmetim i Imam Buhariut).

Muhamedi a.s. nuk i ka lejuar sahabet e tij qe, ndonese, ishin Arabe autentike ta mesojne Kur'anin ne menyre te pavarur por u ka rekomanduar qe mesimin e Kur'anit ta marrin tek keta kater as'habe. Eshte evidente, se vete Muhamedi a.s. ka rekomanduar praktikimin e nje metode te ketille tejet efikase. Prandaj, mbeshtetur ne traditen e Muhamedit a.s. mund te perfundojme se kusht i domosdoshem per pervetesimin e mirefillte te mesimeve Kur'anore eshte ekzistimi i dy subjekteve: mesuesi dhe nxenesi, pra hafizi dhe kandidati per hifz.

12. Ne praktiken e perditshme eshte verifikuar si e suksesshme edhe kjo metode: Kandidati per hifz me te mbaruar te nje pjese te Kur'anit i preferohet qe edhe kuptimin e asaj pjese, d.m.th. te atyre ajeteve t'i mesoje (shkurtimisht tefsirin e tyre). Me kombinimin e ketyre dy komponenteve (hifzi dhe tefsiri) eshte thuajse e pamundur te harrohen ajetet.

Per te ilustruar me mire konstatimin e mesiperme e kemi shembullin e Ibni Umerit r.a. i cili per tete vite me radhe njekohesisht e ka mesuar dhe ka praktikuar kaptinen EI-Bekare, keshtu qe ne shenje falenderimi ndaj Allahut xh.sh. e ka therre nje deve. Prandaj, edhe ky fakt na deshmon se as'habet e Pejgamberit a.s. ajetet Kur'anore njekohesisht i kane mesuar dhe i kane zbatuar.

13. Ne nje hadith transmetohet edhe kjo metode e praktikuar nga ana e Muhamedit a.s.: "Ua mesonte sahabeve te tij nga pese ajete", nderkaq ne nje transmetim tjeter thuhet nga "dhjete ajete".

Ne menyre qe Kur'ani te mesohet me shpejte e me mire rekomandohet qe kandidati per hifz t'i filloje ketij angazhimi nga mosha femijnore (prej 5 deri 10 vjec), fakt ky i cili ilustruhet edhe nga proverbi arab: "Dituria ne femijeri eshte si shenimi mbi gur". Poashtu, ka qene tradite e Muhamedit a.s. qe femijeve shtate vjecare t'ua mesoje ajetin e fundit nga kaptina El-Isra" (KULID'ULLAHE EVID'URRAHMAN...).

Pas metadave te permendura ekzistajne edhe tri metada tjera te posacme per hifz: a) Te mesahet faqja e fundit nga secili xhuz, pastaj faqja e parafundit e keshtu me radhe. Mbarimi i nje faqeje nga cda xhuz quhet "**Nje dever**" (nje rrattullim).

Kjo metode praktikohet ne Kosove, Maqedoni, Bosnje, Shqiperi, Turqi etj. Rendesia e aplikimit te kesaj metode kansiston ne perseritjen me te lehte te Kur'anit.

b) Te fillohet mesimi nga fundi i Kur'anit nga suret e shkurtera e duke vijuar keshtu deri ne fillim te Kur'anit. Ne institucionet e Kur'anit ne vendet arabe, per kandidatet e moshes prej 7 -15 vjecare praktikohet kjo metode e te mesuarit.

c) Te fillohet mesimi nga fillimi i Kur'anit duke vijuar keshtu me radhe deri ne fund te Kur'anit. Ne vendet arabe per te rriturit aplikahet kjo metode⁵.

SI TE PERFORCOHET HIFZI

Metodat me te preferueshme per perforcimin e hifzit jane:

a) Hafizi vazhdimisht duhet ta kete Kur'anin ne dore per perseritje;

b) Koha me e pershtatshme per kete perseritje eshte:

⁵ Eshte per te permendur faktin se une e kam mbaruar hifzin me kete metode, dhe personalisht mendoj se kjo eshte nje metode shume praktike dhe e suksesshme.

-gjate faljes se namazeve;

-te behet hatme ne namaz duke i lexuar kaptinat me rend nga 4-5 faqe ne dite ne namazin e sabahut, akshamit e te jacise;

-vazhdimisht te lexohet Kur'ani para xhematit (mukabele) me Kur'an te mbyllur e jo te hapur;

-me ardhjen e muajit te bekuar te Ramazanit duhet te intensifikohet aktiviteti i perseritjes se Kur'anit duke i falur teravite me hatme, me c'rast per cdo nate duhet te lexohet nga nje xhuz ne namaz.

Muhamedi a.s. per cdo vit ne muajin Ramazan ne teresi e ka perseritur Kur'anin para Xhibrilit a.s., ndersa ne ate vit qe kishte per te nderruar jete, Muhamedi a.s. dy here e perseriti Kur'anin para Xhibrilit a.s.

-Te behet leximi i Kur'anit gjate faljes se namazit nafile, (namaz i nates). Ka qene tradite e gjeneratave te hershme (Selefus-salih) qe ata ditin ta gjallerojne me vepra te mira ndersa naten me lexim te Kur'anit.

Se fundi, duhet qe besimtares e sidomos hafizllaret te tregojne devotshmeri ne zbatimin e parimeve Kur'anore, syneteve te Pejgamberit a.s. dhe t'i luten Allahut xh.sh. qe t'u jepe begati ne punet e tyre dhe ne mesimet e perfituara.

Ne radhe te pare keto metoda jane te dedikuara per fillestaret e hifzit te Kur'anit, per nxenesit e medreseve, per studentet e shkollave te larta te cilet shpesh ballafaqohen me probleme gjate mesimit te Kur'anit. Mirepo, keto metoda lirisht mund te praktikohen edhe per pervetesimin e teksteve shkollore ose univerzitare te lendeve te tjera.

NJE KESHILLE EKSKLUZIVE PER HAFIZIN

Hafizi ne menyre qe te persose stilin e vet preferohet qe vazhdimisht te percjelle kasetat audio-vizuele te lexuesve te ndryshem ne menyre qe leximi i tij te jete sa me afer origjinalitetit te gjuhes arabe, perkatesisht qe keta lexues te jene arabe, p.sh. Hafiz Abdul-Basit, Mahmud Halijl EI-Husari, Muhammed Siddijk EI-Menshavij, Ahmed Nuajna, etj.

APEL PER TE GJITHE BESIMTARET ISLAME

Apelohen te gjithë besimtaret e fese islame qe konform tradites qe ka ekzistuar nder Muslimanet per mesimin e hifzit, maksimalisht te mbeshtesin financiarisht ngritjen e objekteve, lokaleve per organizimin e kurseve te posaqme me hafizllare. Ne kete menyre do te pertrinim traditen e lavdishme islame te hifzit qe dikur eshte kultivuar ne trevat tona⁶.

Elhamdulillah, disponojme me kuadro te specializuara per kete qellim te rendesishem, andaj edhe besimtaret bemiresa le t'i shfrytezojne mundesite e tyre materiale dhe kuadrot e cekura aftesite e tyre profesionale dhe insha-Allah realizohet ky qellim i larte.

Pa dyshim, qeshtja e trajtuar eshte shume e gjere dhe ka ende cka te diskutohet perkitazi me kete, ndaj u perpoqa qe brenda mundesive te mia modeste kete lemi ta perpunoj dhe t'i ofroj disa metoda me te preferueshme ne lidhje me aspektin e trajtuar, duke u perpjekur qe te nxjerri e ta permbledhi esencen nga nje mori e literatures se konsultuar si baze per kete qeshtje, dhe duke u mbeshtetur ne hadithin e Muhamedit a.s. qe thote: "*Ne cofte se i besohet nje detyre dikujt qe nuk eshte kompetent per te, atehere priteni kiametin se eshte afer*", dhe ne ajetin Kur'anor ku Allahu xh.sh. thote: "*Allahu ju urdheron qe detyrat e rendesishme t'ua jepni atyre qe u takojne*". (En'Nisa, 58).

Allahut xh.sh. i drejtohem dhe Atij sinqerisht i falenderohem qe me beri te mundur ta pergatis kete broshure per dashamiret e

⁶ Vlen te permendet se Prizreni ka qene qender e kesaj tradite islame ku kane dalur hafiza te shquar te Kur'anit nga Medreseja "Mehmed Pasha". Poashtu, Gjakova. Peja i kane pasur keto qendra te hifzit. I lutemi Allahut xh.sh. qe ajo tradite e hershmee te kthehet ne keto vende.

Kur'anit duke ndjere pergjegjesi ndaj besimtareve islame ne pergjithesi, e ne vecanti ndaj hafizllareve, ne menyre qe atyre dikush t'ua ndriqoje kete rruge perparimtare, mbase Allahu xh.sh. dikujt ia mundeson qe te pasoje kete rruge. Allahu xh.sh. na udhezofte ne rrugen e Kur'anit dhe na befte prej atyre te cilet e lexojne rrjedhshem ate, dhe te cilet punojne sipas parimeve te tij ne kete jete dhe na befte prej atyre qe Kur'ani Kerimi te jete shefatberes ne Ahiret.

VE AHIRU DA 'VANA ENIL-HAMDULILAHİ RABBIL ALEMIJN

FALENDERIMET JANE PER ZOTIN E BOTERAVE.

Hfz.Hajredin Hoxha

Prizren - Kosove

E-mail:drhafezi68@gmail.com

LITERATURA E KONSULTUAR

1. SUNENUL-KUR'RAI VE MENAHIGJUL-MUXHEV-VIDIJNE, Dr. Ebu Muxhahid Abdulaziz EI-Karie
2. TILAVETUL -KUR'ANIL-MEXHIJDI, Esh shejh Abdullah Siraxhud-Dijn
3. ETTIBJANU FIJ ADABI HAMELETIL -KUR'ANI,
Ebu Zekerija Jahja Bin Sherfud-dijn En-nevevij Esh-shafijj
4. ULUMUL-KUR'ANI Dr. Mustafa El-buga- Muhjid-dijn Mistu Vehbij Sulejman Gauxhij
5. TURUKUT-TEDRIJSIT -TERBIJETIL-ISLAMIJETI Abid-teufijk El-hashimij
6. KEJFE TEHFADHUL -KUR'ANE Esh shejh Muhamed El-habesh
7. ET -TEXHVIJDUL -MUJESSERU Dr. Ebu Muxhahid Abdulaziz EI-Karie
8. ILMUT TEXHVIJDIL-KUR'ANI Muhamed Hisham El-burhanij
9. SHERHUL-MUKAD-DIMETIL-XHEZERIJETI FI ILMIT -TEXHVIJDI Shejhul islam Zekerija EI-ensarij
10. MENDHUMETUL -MUKADDIMETI FIJMA JEXHIBU ALA KARI'IL KUR'ANI EN JA'LEMEHU Muhamed Ibnil Xhezerij Esh-shafijju